



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 21 maj 2010
Ref. Nr.: RK 18/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 04/09

Parashtrues i kërkesës

Spartak Dervishi

kundër

Vendimeve të Gjykatës Komunale në Gjakovë, Aktvendimi nr. P.nr.74/2002 dhe ai i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Aktvendimi Nr. Ap.nr.78/07

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton Vendimin në vijim mbi papranueshmërinë, që ka të bëjë me Kërkesën:

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtrues i Kërkesës është z. Spartak Dervishi, nga komuna e Gjakovës, i përfaqësuar nga avokatët, Avdi Rizvanolli dhe Teki Bokshi, të dy nga Gjakova.

Vendimet e kundërshtuara

2. Aktvendimi nr. P.nr.74/2002 lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Aktvendimi nr. Ap.nr.78/07 lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

Lënda

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dënimi i tij për tri veprat për vjedhje të rëndë, sipas nenit 253.1.1 të KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës), për të cilën është dënuar në shtatë muaj burgim, duhet të përmbysset në bazë të faktit se nuk i është dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së parë, se avokati i tij nuk kishte kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen në këtë rast dhe se është dashur të merren parasysh dëshmitë e reja. Dëshmitë e reja janë se ai vuan, apo ka vuajtur nga "Psikoza e Paranojës".

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Ligji), si dhe neni 55 i Rregullores së Punës së të Republikës së Kosovës.

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 20 shkurt 2009. Kryetari i Gjykatës emëroi Iliriana Islamin Gjyqtare Raportuese. Kolegji Shqyrtues i Gjykatës u emërua në përbërje të Gjyqtarëve Altay Suroy, Kryesues, Ivan Čukalović dhe Almiro Rodrigues. Më 9 shkurt 2010, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Kërkesën e Parashtruesit dhe mori vendim mbi pranueshmërinë e saj.

Faktet

6. Faktet e rastit ishin si në vijim:
 1. Parashtruesi i kërkesës është dënuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë më 11 shkurt 2005 për kryerjen e tri veprave penale të vjedhjes së rëndë.
 2. Dy nga veprat pohohet se janë kryer më 28 dhjetor 2001 dhe një vepër e penale e vjedhjes më 24 dhjetor 2001.
 3. Sipas Aktgjykimit, ai u dënua me shtatë muaj burgim ku është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 30 dhjetorit 2001 deri më 24 janar 2002 dhe përmbarimi i Aktvendimit nr. P.nr.74/2002, datë 11 tetor 2005, hyn në fuqi menjëherë pas vuajtjes së dënimit.
 4. Avokatët e tij kanë ushtruar ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë më 20 qershor 2007.
 5. Gjykata e Qarkut në Pejë e hodhi poshtë ankesën më 9 prill 2008 si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale.
 6. Në ankesën tjetër të ushtruar para Gjykatës së Qarkut më 9 prill 2008, është prezantuar një dëshmi e re, e cila theksonte se Parashtruesi i kërkesës ishte ligjërisht i papërgjegjshëm, sipas dëshmimeve të reja mjekësore të lëshuara nga Spitali i Psikiatrisë, në të cilin ai iu nënshtrua trajtimit prej 16 qershorit 1999 deri më 3 korrik 1999 dhe në të cilin është diagnostifikuar me "psikozë të paranojës".
 7. Gjykata Komunale në Gjakovë nxori urdhrin më 26 janar 2009, i cili obligonte Parashtruesin e kërkesës që të paraqitet para Gjykatës për të vuajtur dënimin e tij të shqiptuar, me kërcënimin e arrestimit nga ana e Policisë.

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

7. Më 23 shkurt 2009 është parashtruar Kërkesa pranë Gjykatës Kushtetuese, KI 04/09, përmes së cilës kundërshtohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e Vendimeve të

Gjykatës Komunale të Gjakovës, Aktvendimi nr. P.nr.74/2002 dhe i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Aktvendimi nr. Ap.nr.78/07

8. Më 20 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë u përgjigj në kërkesën e Gjykatës për ofrimin e informatave mbi rastin dhe bashkëngjiti Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rastin e Parashtruesit të Kërkesës, më 28 prill 2009.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

9. Parashtruesi thekson se baza e kërkesës së tij është neni 31 i Kushtetutës, ndonëse nuk saktëson apo specifikon se në çfarë mënyre neni 31 mbështeste kërkesën e tij. Neni 31 i Kushtetutës përcakton të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Neni 113.7 i Kushtetutës parasheh si në vijim:
10. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
11. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

12. Në kërkesë, Parashtruesi nuk ka cekur apo përkufizuar në mënyrë të qartë se cilat të drejta dhe liri ai pretendon se i janë shkelur.
13. Dëshmitë mjekësore në të cilat Parashtruesi mëton të mbështetet i referohen një diagnoze dhe periudhe të trajtimit para kryerjes së veprave për të cilat ai është ngarkuar. Siç është theksuar në Aktvendimet e Gjykatave të cilat e kanë shqyrtuar rastin e tij, gjendja e tij mjekësore nuk është ngritur nga ana e tij apo avokatëve të tij mbrojtës gjatë gjykimit të tij dhe dëshmia e paraqitur tani nuk është aq bindëse për t'i mundësuar atij që të mbështet kundërshtimin e tij të dënimit më tutje.

PËR KËTO ARSYE

14. Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe nenin 55 të Rregullores së Punës, në seancën e datës 21 maj 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. PËR TË REFUZUAR kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'i dërgohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.